E K S T R A K T

i procesverbalit nga sesioni i dëgjimit publik, mbajtur më 28.06.2022, me fillim në orën 10:00.

- **Ndryshimi i Rregullores për bashkësitë lokale.**

Sesionin e dëgjimit publik e hapi dhe e kryesoi zyrtari i Komunës, z. **Osman Bllaca.**

Osman Bllaca tha se diskutimi ka për qëllim plotësim-ndryshimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Prishtinës. Kjo rregullore është miratuar në vitin 2018, por më pas në vitin 2019, është nxjerrë një udhëzim administrativ, i cili ka ardhur nga Ministria, dhe ne obligohemi që ta ndryshojmë këtë rregullore, e cila fillimisht si procedurë shkon në Kuvendin e Komunës, ku e kemi marrë miratimin për konsulta paraprake, që i bie për diskutime publike që do t'i organizojmë gjatë kësaj periudhe. Ky është njëri nga organizimet që e kemi mbajtur në vazhdimësi, sipas nevojës dhe kërkesave që dalin do të mbajmë ndoshta edhe takime të tjera.
Qëllimi i diskutimeve publike zakonisht është dhënia e rekomandimeve, sugjerimeve dhe kërkesave, të cilat mund t'i inkorporojmë në rregullore, me qëllim të begatimit të saj, që ta bëjmë një dokument sa më të mirë, i cili do të përmbushë sa më shumë nevojat dhe kërkesat e qytetarëve. Duke e parë rëndësinë dhe rolin që e ka Bashkësia lokale në kuadër të organizimit të Komunës dhe të komunitetit të lagjes apo fshatit i cili është edhe kontakti i parë me qytetarë.

Bersant Beka, drejtor i Drejtorisë së Administratës, tha se **k**am kënaqësinë që para jush në pika të shkurta të prezantojë disa prej ndryshimeve që i kemi bërë dhe jemi duke i përfshirë në Rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës.
E rëndësishme është që të ju njoftojmë se plotësim-ndryshimi i kësaj rregulloreje është imediat, për shkak se nga viti 2019, kur është hartuar Udhëzimi i ri administrativ nga MAPL,

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë Telefon:
+ 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

me nr. 02/2018, nuk është ndërhyrë në këtë rregullore, ku për pasojë ka penguar deri në një masë funksionalizimin e organizimit të këtyre organeve dhe mekanizmave lokalë, siç e ceki më herët edhe z. Bllaca.
Duke e marrë parasysh se prej shumë vitesh nuk është zhvilluar proces i përzgjedhjes së përfaqësuesve të këshillave lokalë, konsideroj se është i domosdoshëm ndryshimi i kësaj rregulloreje.
Me këtë propozim-ndryshim të kësaj rregulloreje që sot në këtë sesion do t'i marrim edhe komentet tuaja për të qenë pjesë e hartimit të një projekti final, i cili do të përfshijë interesin e qytetarëve, synim të vetëm kemi fuqizimin e bashkëpunimit të Komunës me qytetarët e saj.
Si kronologji, kjo ka ndodhur fillimisht nga z. Përparim Rama, kryetar, i cili ka marrë një vendim dhe ka formuar komisionin prej pesë anëtarëve. Më pas ata kanë propozuar ndryshimet në rregullore, në të cilën përfshihen nenet 5, 11 dhe 13 të rregullores së vjetër.
Ndryshohet dhe riformulohet neni 4, paragrafi 4.1 i rregullores bazike, me tekstin si në vijim:
Neni 4.1 – Kuvendi i Komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punët në terren në zgjedhjet e këshillave lokalë. Komisioni duhet të ketë shtatë anëtarë, katër anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshme politike, një anëtar nga ekzekutivi, një anëtar nga Shoqëria civil edhe një përfaqësues i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane nga lokaliteti ku do të mbahen zgjedhjet e këshillit lokal.
Nga shtatë anëtarët e komisionit, tri duhet të jenë femra, si dhe një anëtar patjetër të jetë i komunitetit jo shumicë. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës.
Kryesuesi i komisionit zgjidhet nga anëtarët e komisionit, kjo është vetëm për nenin 4, ndërsa ndryshimi për nenin 5, paragrafi 5.12 dhe paragrafi 5.13 të rregullores bazike në tekstin si në vijim 5.12, anëtarët dhe kryetarët e këshillave lokalë të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane zgjidhen me mandat për katër vjet.
Neni 5.13 tubimet e kanë legjitimitetin juridik nëse në tubime janë të pranishëm së paku njëzet pjesëmarrës me të drejtë vote të atij lokaliteti, përfaqësimi në këshillat lokalë, duhet të reflektojë përfaqësimin gjinor dhe etnik.
Neni i fundit është neni 13 i rregullores, me tekstet dhe paragrafët e ri, si në vijim, 13.1, për punën e tyre kryetarët e këshillave lokalë kompensohen nga buxheti i Komunës; neni **13.2** parasheh kompensimin për kryetarët e këshillave lokalë, që bëhet me shumën ekuivalente të anëtarëve të komiteteve obligative.
Neni 13.3 parasheh kompensimin për pjesëmarrjen në takime, që bëhet vetëm për gjashtë takime të këshillit lokal të mbajtura brenda një viti kalendarik.
Duke e marrë parasysh këtë ndryshim të domosdoshëm, gjithashtu duke e pasur mundësinë e dhënies së komenteve nga ana e juaj, pres që të diskutojmë dhe të nxjerrim një rregullore më të mirë.

Lidhur me ndryshimin e Rregullores për bashkësitë lokale, **Osman Bllaca** hapi diskutimin.

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë Telefon:
+ 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

Naser Gashi, banorë i Prishtinës, njëherësh përfaqësues i fshatit Butovc, shtroi pyetje, duke pyetur se si është bërë ndarja gjeografike e bashkësive lokale, pasi që fshati Butovc është lënë anash dhe nuk është investuar asgjë, as në rrugë, as në infrastrukturë e në të gjitha vevojat tjerat. Ai tha se tash e 22 vjet veproj në këtë territor, kam bërë kërkesa në vazhdimësi për rregullimin e infrastrukturës së rrugës në atë pjesë, por kam bërë kërkesë edhe për fshatin Mramor, ku kërkesa e fundit është bërë më 02.06.2022. Qytetarët e fshatit Butovc kërkojnë të ndahen nga Bashkësia lokale e Mramorit, pasi që ata kurrë nuk kanë bërë kërkesë për fshatin Butovc, mundësisht të bëhet një bashkësi e re lokale.

Bajram Sopi, qytetari i Prishtinës, njëherësh edhe i fshatit Butovc**,** u shpreh i pajtimit me kërkesën e parafolësit, z. Gashi, sepse është shumë e arsyeshme kërkesa, pasi që ne jemi në Prishtinë dhe i kemi të gjitha mundësitë që t'i bashkëngjitemi Bashkësisë lokale të Bregut të Diellit, të cilën e kemi më së afërmi, apo Bashkësisë lokale në Matiçan, pasi që komunikimin dhe aktivitetet i kemi në Prishtinë. Për të shkuar në Mramor ne duhet ta humbim një gjysmë dite, për të shkuar për të rregulluar ndonjë dokument në Bashkësi lokale.

Bersant Beka tha se sa i përket pyetjes së z. Gashi, ndarja gjeografike është bërë në bazë të zonave kadastrale, ku ka pasur edhe ekspertë të kadastrit, si dhe të urbanizmit, dhe ata e kanë paraparë atë zonë. Por ne duhet shikuar se çka me bërë tutje, me e ndarë me e lënë si të veçantë, apo me iu bashkëngjitur zonës të cilën e kanë më afër, të Matit ose të Bregut të Diellit siç propozoi edhe z. Bajrami.

Naser Gashi tha se unë dhe Bajrami shtëpitë i kemi pasur afër Farmakosit në Bregun e Diellit, mirëpo toka është në Matiçan, kurse me bashkësi lokale jemi në Lagjen e Muhaxhirëve, prandaj disa gjëra duhet t'i keni parasysh, pasi që në ndarjen gjeografike në bazë të zonave kadastrale ka mospërputhshmëri, ku njëra ndër to është edhe kjo me Butovcin.

Qerim Sharbani, në cilësinë e kryetarit të Bashkësisë lokale në Llukar, tha se sa i përket rregullores është bërë shumë mirë që do të ndërhyhet me disa plotësim-ndryshime, por nuk më ka pëlqyer se titulli "bashkësitë lokale" është hequr, ku për këtë arsye atë ditë nuk e kam votuar. Atë ditë kur kryetari e ceku disa herë se kanë me u bërë bashkësitë lokale më vinte shumë mirë, pasi që pikënisja e qeverisjes lokale është bashkësia lokale.
Ai njëherësh tha se koordinimi duhet të jetë me kryetarin dhe shefin e sektorit të bashkësive lokale, qysh do t'i bënin prioritetet kryetarët e bashkësive lokale me nën këshilla që hasen nëpër fshatra, e jo me ua dhënë sikurse vitin e kaluar kodet. E kam thënë atë, të mos përsëritet edhe njëherë, iu kanë dhënë kodet disa projekteve, por as nuk ka projekt, as nuk ka fizibilitet!

Bersant Beka u shpreh se ne e kemi rregulloren e vjetër, nuk mundemi me dalë jashtë saj, për atë është plotësim-ndryshim, me u bërë rregullore e re duhet nisur procedura më të gjata. Meqenëse nga viti 2012 nuk ka pasur zgjedhje nëpër këshilla lokalë, ne e kemi parë të arsyeshme, bashkë me kolegun, Fadilin, që duhet me bërë vetëm plotësim-ndryshimin, pastaj

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë Telefon:
+ 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

pasi që të kryhen zgjedhjet ne do të hyjmë ta shqyrtojmë edhe një herë rregulloren. Nuk mundemi me e ndryshuar emrin, është e caktuar sa për qind mundet me u ndërruar, për atë i diskutuam këto tri nenet të cilat i lexova. Nuk kisha dashur me u kthyer më prapa, se tash veç ka filluar në Hajvali, do të rifunksionalizohet edhe në lagjen "Tophane", gjithashtu në Besi dhe Mramor.
Do të ketë edhe zyrtarë të gjendjes civile, si në Mramor e Besi, ku ka me qenë referenti i Bashkësisë lokale.

Fadil Leci, zyrtar i Sektorit të bashkësive lokale, tha se ka më shumë se një vit që kemi punuar bashkë me ekspertët e urbanizmit dhe të kadastrtit për plotësimin e kësaj rregulloreje. Këtu është bërë një punë shumë e mirë në këtë rregullore, është definuar përshkrimi shumë i qartë i secilës bashkësi lokale, e tash me e ndryshuar rregulloren na duhet së paku edhe një vit.
Ne kemi të bëjmë vetëm me ndryshimin e këtyre pikave në rregullore.
Çështja e bashkëpunimit të këshillit dhe anëtarëve është çështje e brendshme, d. m. th. secili anëtar i këshillit e ka të drejtën për pjesën të cilën e përfaqëson, me i mbrojtur interesat e veta.

Naser Gashi tha se që nga viti 1878 d. m. th. mbi 140 vjet ka ekzistuar fshati Butovc, për çka ekzistojnë tapitë, ku shkruan shtëpitë, oborri, ara, bahçja, që dëshmi më të forta se dokumentet që ekzistojnë nga pronarët nuk di çka duhet me pasur tjetër.
Prandaj, këto janë argumente që e fuqizojnë, nëse është bërë ndonjë gabim edhe nuk figuron si fshat, nuk figuron shkaku i infrastrukturës.
Prandaj, në emër të këtyre qytetarëve, me të drejtë kërkoj që të jetë një bashkësi e re lokale, apo këshill i ri, sepse këto janë elemente që na bëjnë të fuqishëm me kërkuar që vërtet të formohet një këshill i ri.

Behxhet Reçica përfaqësues nga fshati Vranidoll, tha se edhe në fshatin Vranidoll nuk është investuar fare, prandaj dëshirojmë ta dimë arsyen.
Përderisa në Besi është investuar, është investuar edhe në Prugovc, ku janë rregulluar rrugë e rrugica, kanalizimi, shkolla etj. në pesë mëhallë.
Bashkësia lokale nuk është interesuar asnjëherë për ne, sikur të mos ekzistonim fare. Asnjëherë nuk është thirrur ndonjë mbledhje që të dëgjohen kërkesat dhe hallet tona, pra pse nuk po merren parasysh kërkesat tona?
Ai pyeti se a është në projekt dhe në plan që të investohet diçka në Vranidoll.

Osman Bllaca tha se ky është diskutim krejt tjetër, ato çka i potencove qëndrojnë edhe janë kërkesa shumë të rëndësishme, por ky është një diskutim tjetër. Ne jemi duke e hartuar një Rregullore për bashkësi lokale edhe çka ka lidhje me bashkësi lokale që ne mundemi me i inkorporuar në këtë rregullore duhet me i prezantuar sot në këtë diskutim.
Për shkollë nuk mundemi me të dhënë përgjigje, se ajo është tjetër, është Drejtoria e Arsimit, i kemi pasur diskutimet me qytetarë, i mbajmë prapë, kemi projekte të ndryshme, kur ta

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë Telefon:
+ 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

hartojmë buxhetin, kur të kemi për plan të veçantë që është për Drejtori të Arsimit ose edhe kërkesat tjera që kenë për emërtim të rrugëve.

Bersant Beka theksoi se sa i përket diskutimit të z. Reçica, për të mos ardhur deri tek këto problemet dhe problemet e qytetarëve me u adresuar në një vend, ne për atë po e bëjmë zgjidhjen, ku edhe qasja e kryetarit të atij këshilli lokal e ka më të lehtë qasjen tek secila drejtori, e duke nisur prej administratës për problemet, siç the për emra, për informim më të gjerë për shkollën, kanalizimi etj.
Për atë ne po përpiqemi ta hartojmë një rregullore, që do t'i japim edhe përgjegjësi edhe kërkojmë përgjegjësi, por njëkohësisht me na dhënë edhe informata.
Ne informatat po mendojmë me i marrë nga kryetari i atij këshilli lokal, së pari ta zgjedhim e pastaj fillojmë me procedurat tjera.
Në momentin që kryhet rregullorja caktohen terminet, fillojnë zgjedhjet, kryhen, do të thotë kanë me pasur edhe mjet identifikues, d.m.th. bexh identifikues, që të kenë një qasje më të lehtë në Komunë. Kanë me qenë më të hapur edhe për informata, edhe për të gjitha çështjet.

Shkumbin Demolli, në cilësinë e gazetarit, tha se e kemi një ankesë lidhur me Trafikun Urban. Unë jetoj në rrugën "Bajram Bahtiri", ne duhet të marrim veturë për të shkuar në punë, sepse Trafiku Urban është vetëm pesë herë në ditë.
Po ashtu, Trafiku Urban edhe pse e ka pesë herë në ditë linjën, shkon deri në Prapashticë e nuk vjen në Gllogovicë, e që nuk ka distancë më shumë se shtatë kilometra. Këtë problem e kemi paraqitur disa herë dhe po e kërkoj mirëkuptimin tuaj.

Osman Bllaca tha se lidhur me këto kërkesa ne sot nuk mundemi me ju dhënë përgjigje, por ju kishim lutur edhe njëherë që të përqendrohemi sa më shumë në rregullore, sepse ky është qëllimi, ndonjë nen, ndonjë ndryshim, kërkesë për bashkësi lokale. Kjo kishte me qenë tamam që përkojnë me këtë, ndërsa lidhur me këto kërkesat ne nuk po dimë as çka me ju thënë tash se drejtori nuk është kompetent për këtë. Nuk ju kemi ftuar këtu për qëllime se ne e dimë se është problem i rëndësishëm dhe jetik për juve, por nuk përkon me çështjen që diskutojmë sot.

Bajram Sopi tha se ne çdo aktivitet që e kemi pasur lidhur me aktivitetet që i përkasin Bashkësisë lokale, këshillave, ne zakonisht kemi ardhur në Prishtinë e jo në Mramor.
Kështu që ajo kërkesa që e shtroi më herët parafolësi, Naseri, është shumë e arsyeshme. Ne po duam që ndonjë anëtarë i këshillit me qenë i Butovcit në kuadër të Bashkësisë lokale që vepron më afër e jo në Mramor.

Bersant Beka tha se do ta shqyrtojmë dhe do të shikojmë se çka mund të bëjmë për ndryshimin, por ne gjithsesi duhet me u konsultuar edhe me Drejtorinë e Kadastrit dhe Drejtorinë e Urbanizmit, që të na i sjellin ekspertët që e kanë bërë ndarjen paraprake dhe me shikuar se si me i inkorporuar ose në Matiçan, ose në zonën e Bregut të Diellit.

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë Telefon:
+ 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

Osman Bllaca tha se duhet pasur parasysh se krahasuar me rregulloret e kaluara, numri i bashkësive lokale është shtuar, diku më tepër se 11 bashkësi lokale janë shtuar, andaj sa herë kemi pasur mundësi dhe nevojë për shtim të një bashkësie lokale e kemi bërë.
Ka më shumë se 11 vjet që nuk kemi mbajtur zgjedhje në bashkësi lokale. Kryetarëve aktualë iu ka kaluar mandati kaherë por në kësi forme kanë vepruar.
Drejtori i Drejtorisë së Administratës në bashkëpunim me Kuvendin dhe ekzekutivin, besoj se gjatë verës do t'i mbajnë zgjedhjet nëpër bashkësitë lokale. Ata e hartojnë një plan, plani do të bëhet publik dhe për secilën bashkësi lokale ka me u bërë edhe njoftimi se kur mbahen zgjedhjet aty, kur mbahen organizimet edhe do të jenë të mirëseardhur kur të bëhet edhe përzgjedhja e kryetarëve dhe kryesive të atyre bashkësive lokale.

Adnan Zeneli, qytetar i Prishtinës, tha se sa i përket hartave dhe vendndodhjen e vendeve ku ju po kërkoni, janë vendet strategjike të ish armatës së Jugosllavisë, ato kanë qenë të fshehura gjithnjë, janë vetëm nëpër kadastër e jo kështu në hartë, për atë ka qenë ajo e larguar, është harta, por nuk janë vendet se nuk i tregon vendet.

Osman Bllaca tha se është grupi punues që është duke punuar për këtë rregullore, si në aspektin ligjor edhe në aspektin e së drejtës, do të veprohet për hartimin e një rregulloreje sa më të mirë.

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë Telefon:
+ 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë Telefon:
+ 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

Pjesëmarrja në diskutimin publik lidhur me Projektrregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Prishtinës nr.01-030/01-0134831/18, e dt. 06.06.2018,e mbajtur në Komunën e Prishtinës, më 28.06.2022

	Emri dhe Mbiemri	Gjinia M/F	E-mail	Nënshkrimi
1	Qerim Adem			
2	Behxhet Regica			
3	BAJRAM SOPI			
4	Naser Gashi			
5	BUJAR GASHI			
6	ADNAN ZENELI			
7	NAIM Reshka			
8	Salih Asllani			
9	Khairi Osmani			
10	Naim Gashi			
11	Donika Ahmetaj			
12	Bahri Gashi			
13	Sami Sopi			
14	SHKUMBIN DEMOLLI			
15				